

MINISTRIA E DREJTËSISË

DITARI MUJOR

KORRIK 2024



INAUGUROHET STRUKTURA MODERNE IEVP POJSKË, MINISTRI MANJA: TRAJTIM DINJITIZ PËR VAJZAT DHE GRATË NË KONFLIKT ME LIGJIN!



Ministri Manja së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve z. Klevis Qose, me prezencën e Avokates së Popullit znj. Erinda Ballanca, ambasadorit të Mbretërisë Britanike Alastair King-Smith, ambasadorit të Mbretërisë së Holandës, përfaqësues nga ambasada e SHBA, të autoriteteve vendore, përfaqësues të besimeve në Pogradec, përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile që monitorojnë sistemin e burgjeve, inauguruan IEVP-në e re në Pojskë, Pogradec. Kjo strukturë moderne, e ndërtuar në përputhje me rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe CPT, do të akomodojë vajzat dhe gratë në konflikt me ligjin. Kthimi i IEVP Ali Demi në një burg të hapur dhe mbyllja e institucioneve të trashëguara nga e kaluara komuniste tregojnë angazhimin e palëkundur të qeverisë Rama për reformimin e sistemit penitenciar dhe respektimin e të drejtave të njeriut.



TAKIM ME DELEGACIONIN E LARTË AMERIKAN TË GJYQËSORIT, FOKUSI: REFORMA NË DREJTËSI

Një takim i mirë pune dhe një bisedë e hapur me profesionistë të shkëlqyer të ligjit mbi ecurinë dhe sfidat e drejtësisë së re në Shqipëri, me të nderuarën Trina Higgins, Prokurore e SHBA-së për Distriktin e Utah; Kryegjyqtarin Robert Shelby, nga Gjykata e Qarkut të Utah; dhe gjyqtaren Paige Petersen e Gjykatës së Lartë të Utah. Mbështetja dhe partneriteti i ngushtë i Shqipërisë me SHBA për jetësimin e plotë të reformës në drejtësi është rruga e duhur për forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë si qëllimi kryesor i reformës!



FORCIMI I MARRËDHËNIEVE SHQIPËRI-RUMANI, MANJA PRET MINISTREN E DREJTËSISË SË RUMANISË

Ministri Manja së bashku me Znj. Klotilda Bushka pritën Ministren e Drejtësisë së Rumanisë, znj. Alina Ștefania Gorghiu, e cila shoqërohej nga Presidenti i Komitetit të Çështjeve Ligjore, Mandateve, Disiplinës, Imuniteteve dhe Vlefshmërive të Senatit Rumun, z. Cristian-Agustin Niculescu-ȚĂGĂRLAȘ. U diskutua mbi marrëdhëniet e shkëlqyera parlamentare dhe bashkëpunimin ndërmjet dy ministrive të drejtësisë. Palët në këtë takim u dakordësuan për rivitalizimin e marrëveshjes në fushën civile dhe familjare dhe fillimin e punës për të gjitha çështjet e dakortësuara në deklaratën e mirëkuptimit të firmosur në Bukuresht në qershor të vitit 2022 nga dy ministratë e drejtësisë. Rumania si shtet mik i Shqipërisë në BE është e gatshme të na ofrojë mbështetje për integrimin europian, asistencë ligjore dhe shkëmbim përvojash në fushën e drejtësisë. Një hap i rëndësishëm drejt forcimit të marrëdhënieve tona në fushën e drejtësisë!



FRYTET E PARA NGA PËRFSHIRJA E SHQIPËRISË NË PROGRAMIN EVROPIAN TË DREJTËSISË DHE ANËTARËSIMI NË AKADEMINË E SË DREJTËS EVROPIANE ERA

Anëtarësimi i Shqipërisë në Akademinë e të Drejtës Evropiane (ERA) dhe bërja e Shqipërisë pjesë e programit evropian të drejtësisë po jep frytet e para! Ministri Manja takoi Drejtorin e ERA, z. Jean-Philippe Rageade, ku diskutuan për jetësimin e disa projekteve me vlerë në fushën e drejtësisë dhe sundimit të ligjit!



SFIDAT DHE ANGAZHIMET E MINISTRIT TË DREJTËSISË PËR ZBATIMIN E VENDIMEVE TË GJEDNJ NË SHQIPËRI

Me mikpritës Kuvendin e Shqipërisë, Nënkomisioni për Zbatimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës zhvilloi mbledhjen e radhës në Tiranë! I ftuar në këtë aktivitet ishte edhe Ministri Manja, i cili prezantoi kontributin e Ministrisë së Drejtësisë

në zbatimin e vendimeve të GJEDNJ, edukimin e aktorëve ligjorë dhe sfidat për përmirësimin e kapaciteteve tona ligjore dhe institucionale.



MINISTRIA E DREJTËSISË PËRMBYLL ME SUKSES FAZËN E PARË TË EDUKIMIT LIGJOR PËR LIGJIN E RI TË ARBITRAZHIT

Përmbillet me sukses faza e parë të edukimit ligjor dhe promovimit të ligjit të ri të Arbitrazhit. Manja falenderoi të gjithë partnerët për kontributin në promovimin e këtij instrumenti, që do të ndikojë në uljen e stokut të dosjeve përmirësimin e klimës së biznesit dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjyqësore!

